



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.170/21
172/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina -Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “Rahovica Commerce”SH.P.K.-Ferizaj, si dhe OE: N.P.SH“Bageri”-Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: “Haxhi Zejnullahu B.I”; & “Mirusha Company”SH.P.K.-Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra sipas Lot 1 dhe Lot 2 ” , me nr. të prokurimit: 644-20-4423-5-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Vushtri”, më datën: 23.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Rahovica Commerce”SH.P.K.-Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra sipas Lot 1 dhe Lot 2 ” , me nr. të prokurimit: 644-20-4423-5-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Vushtri”,

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.P.SH“Bageri”-Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra sipas Lot 1 dhe Lot 2 ” , me nr. të prokurimit: 644-20-4423-5-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Vushtri”,

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra sipas Lot 1 dhe Lot 2 ” , me nr. të prokurimit: 644-20-4423-5-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Vushtri”, dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues: “Rahovica Commerce”SH.P.K.-Ferizaj, si dhe OE: N.P.SH“Bageri”-Ferizaj, aprovohen si të bazuara dhe pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: “Rahovica Commerce”SH.P.K.-Ferizaj, si dhe OE: N.P.SH“Bageri”-Ferizaj, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 22.02.2021 me nr. 170/21, dhe me datë 25.02.2021 me nr. 172/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra sipas Lot 1 dhe Lot 2”, me nr. të prokurimit: 644-20-4423-5-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK-Vushtrri”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59, 61, 69, si dhe nenin 108/A, të LPP-së, si dhe nenin 39 të RRUOPP-së, të ankesa me nr. 170/21.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 59, 69, si dhe nenin 72 të LPP-së, të ankesa me nr. 172/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirm nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.02.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datë: 07.03.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES : “Rahovica Commerce”SH.P.K.-Ferizaj,

Përgjigje në pretendimin e parë ankimor, Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se AK ka kërkuar nga OSHP të na fut në listën e zeze për këtë pretendim OSHP ka lëshuar një vendim nr.872-879/20 për vërtetësinë e fakteve! Eksperti i OSHP-se sqaron se AK ka pranuar një vendim e mbi të cilin vendim të OSHP-se nr.872-879/20 është vërtetuar në Vendimin 872-879/20, ku inxhinieri Gazmend Himaj është i punësuar ka kontratë, ka diplomë, ka të paguara kontributet si punëtor, ka sjellë diplomën e vërtetuar. AK duhet të zbatojë vendimin e OSHP-se 872-879/20 dhe themi se ky pretendim është i bazuar dhe AK duhet të zbatojë vendimin e OSHP-se për rastin në fjalë. Ky pretendim ankimor pasi është shqyrtuar në vendimin 872-879/20, mund të trajtohet sipas pikës 2.16 të nenit 105 të LPP-se, dhe mund të quhet Res Judicata (çështje e gjykuar).

Përgjigje në pretendimin e dytë ankimor, Lidhur me pretendimin ankimor se AK ka shkelur nenin 1, nenin 6 të LPP-se. Eksperti i OSHP-së, sqaron se: Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK duhet të respektoj nenin 1 dhe 6 të LPP-se, qëllimi i Ligjit është shfrytëzimi sa më ekonomik i buxhetit dhe AK ti kërkojë sqarime shtese në fazën e rivlerësimit që në rast se arrihet kriteri i kërkuar nga OE ankues AK të shpërblen me kontratë OE ankues, në rast se nuk arrihet kriteri i kërkuar AK të vazhdojë me OE tjerë. Pra qëllimi i LPP-se konkretisht nën 59.2, nën 72 të LPP-së dhe nën 39.8 të RRUOPP-së është të kërkojnë sqarime shtese. Pra, AK duke u bazuar në nenin 1 dhe 6 të LPP-së që interesi i AK është të kursejë buxhetin, AK duhet të ketë parasysh këto gjera dhe ka qene dashtë të kërkojë sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, lidhur me listën e projekteve, konkretisht referencat. Duke marrë parasysh kursimin e buxhetit sipas nenit 1 dhe 6 të LPP-se AK për çdo paqartësi mund të kërkojë sqarime sipas nenit 72 të LPP-së.

OE ankues pasi që i plotëson kriteret sipas vendimit 872-879/20, OE ankues është me i lire për LOT 1 – 4,993.93 euro, kurse në LOT 2 – 35,157.98 euro. Pra, Dallimi në mes të OE ankues dhe OE së rekomanduar është 40,151.91 €, që nënkupton se OE ankues është me i lire se OE i rekomanduar.

Pra, AK duhet të ketë parasysh kursimin e buxhetit sipas nenit 1 dhe 6 të LPP-së dhe AK duhet të zbatojë vendimin e OSHP-se nr.872-879/20. Pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e tretë ankimor, Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-se (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve), . Eksperti i OSHP-se, sqaron se lidhur me pretendimin ankimor, AK ka shkelur nenin 59 të LPP-se, dhe 72 të LPP-së sepse duke mos e respektuar vendimin e OSHP-se 872-879, AK bën shkeljen e nenit 59 të LPP-se, andaj AK duhet të ketë parasysh vendimin e OSHP-se 872-879/20 dhe të zbatojë kriteret e kërkuara sipas LPP-se, po ashtu edhe neni 72 i LPP-se shkelet nga AK sepse sipas vendimit të OSHP-se 872-879/20 AK duhet të kërkojë sqarime nga OE për referencat, por AK një gjë të tillë nuk e ka bërë. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje ne pretendimin e katërt ankimor, Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues se AK ka bere shkeljen e nenit 61 te LPP-se, sipas pretendimit te OE ankues ne disa pozicione te paramases se OE-se se rekomanduar. Eksperti i OSHP-se, sqaron se AK lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se OE i rekomanduar ka çmime jo-normalisht te ulëta sipas pozicioneve siç pretendon OE ankues. Poz.3,4,5,8,10,12,13,17,19 dhe 20.

Pozicioni nr.3,4,5,8,10,12,13 ,17,19 dhe 20.

Pozicioni nr.3 Pastrimi i trases nga shkurret, me cmime 0.02 €, kurse cmime i tregut sillet nga 0.20-0.60 €

Pozicioni nr.4 Germimi i dheut te kat.III,IV dhe V me cmime 0.13 €, kurse cmime i tregut sillet nga 0.70 – 1.00 €

Pozicioni nr.5 Germimi i kanaleve anesore me thellesi 60 cm – 0.06 €, kurse cmime i tregut sillet nga 0.20-0.60 €

Pozicioni nr.8 Furnizimi dhe montimi i pusetave te reja 1000/600 si dhe kapaku prej kompoziti me peshe 40T, me cmim 10.00 €, ku vetem kapaku kompozit, kushton nga 80-120 €, ku jemi importues i vetem per Kosove, per materialet kompozit (deshmi DUD-i)

Pozicioni nr.10 Furnizimi, montimi i tubave te brinjezuar plastike Ø 315 mm, me cmim 1.00 €, kurse cmime i tregut sillet nga 6.40-7.50 €

Pozicioni nr.12 Furnizimi dhe punimi i mbushjes me material guror 0-125 mm me cmim 0.16 €, kurse cmime i tregut sillet nga 1.00-2.00 €

Pozicioni nr.13 Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit te thyer gelqeror prej 0-60 mm me cmim 0.16 €, kurse cmime i tregut sillet nga 2.00 – 3.00 €

Pozicioni nr.17 Furnizimi dhe montimi i pahive elastike ne forme te shkronjes B nga materiali hekur i galvanizuar me cmim 2.00 €, kurse cmime i tregut sillet nga 18.00 -23.00 €

Pozicioni nr.19 Betoni C 25-30 me cmim 5.00 €, kurse cmime i tregut sillet nga 40.00 50.00 €, dhe

Pozicioni nr.20 Armatura me cmim 0.10 €, kurse cmime i tregut sillet nga 0.50-0.80 €

Per te gjitha keto ofrojme deshmi se cmimet qe i ka prezantuar nuk mund te mbulohen me cmimet qe i ka vendosur andaj kjo per neve eshte dyshuese se keto cmime jane manipulative.

Pra, OE ankues ka te bashkangjitur ofertën për:

1. Zhavorr
2. Gypa te plastikes
3. Armature

4. Beton

OE ankues ka bashkangjitur disa oferta ne ankesën e tij për:

1.Gyp i bri njëzuar Fi 315 mm – 6.85 €/m'; 6.50 €/m' ;

2.Beton C 25/30 – 42 €/m3; 39.00 €/m3

3.Kapak kompozit – sipas DUD-it Goganor – 61.93 €

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar ka çmime jo-normalisht te ulëta ne pozicionet e lartpërmendura, eksperti i OSHP-se, sqaron se ne lenden a ankesës se OE ankues Rahovica ka te bashkangjitura disa oferta për artikujt e përmendura dhe sipas këtyre ofertave rezulton se OE i rekomanduar ka çmime te ulëta për pozicionet ne fjale dhe AK sipas nenit 61 te LPP-se, te kërkoj sqarime për pozicionet ne fjale, andaj përgjegjësi e AK-se është te veproj konform nenit 61 te LPP-se. Paragrafi 2 i nenit 61 te LPP-së thotë (citim): Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalishtulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me: 1.ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; 2.çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; 3.çfarë do kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, 4.ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose 5.origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara. Pretendimi i ankimor i OE ankues ne këtë pike është pjesërisht i bazuar, sepse AK ka qene dashtë ti kërkoj sqarime shtese OE ankues për çmime jo normalisht te ulëta.

Pretendimi i peste dhe gjashte ankimor, Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se AK ka bere shkeljen e nenit 108/A te LPP-se, dhe shkelja e nenit 7 te LPP-se, nenin 59 te LPP-se. Eksperti i OSHP-së sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se AK-Komuna Vushtrri nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues, është shkelje e nenit 108/A te LPP-së, shkelja e nenit 7 te LPP-se dhe nenit 59 te LPP-se, sepse OE ankues pretendon se AK nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-se nr.872-879/20 për inxhinierin ne fjale, pasi qe lidhur me këtë pike e sqaron qarte vendimi i OSHP-se 872-879/20 dhe për te cilin pretendim për inxhinierin ne fjale është shqyrtuar ne vendimin e mëparshëm dhe AK ne fazën e rivlerësimit ka qene dashtë ta respekton vendimin ne fjale. Pra, Kjo mund te quhet çështje e gjykuar “Res Judicata”, sipas pikës 2.16 te nenit 105 te LPP-se.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: N.P.SH“Bageri”-Ferizaj,

Përgjigje ne pretendimin e pare ankimor, Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka licencën nga KPMM, lidhur me marrëveshjen e noterizuar për furnizim me beton. Eksperti i OSHP-se, sqaron se OE i rekomanduar ka një marrëveshje ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit dhe këtë e sqaron qarte vendimi 872-879/20 qe thotë:

Dëshmia 6. Duhet të dëshmohet kopja e Licencës leje për aktivitete të veçanta, valide dhe e vlefshme e lëshuar nga Agjencia për Minerë dhe Minerale. Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE të licencuar. Bashkangjitur duhet të jete Licenca e OE. Marrëveshja duhet të jete e noterizuar në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar nuk e ka të noterizuar marrëveshjen për Furnizim me zhavorr në emër të qiramarrësit dhe qiradhënësit, kurse OE i rekomanduar nuk e plotëson këtë kriter. Pra, nuk është marrëveshja e noterizuar sipas kërkesës së AK-së, por ka vetëm vërtetim nënshkrimi i dt.11.03.2020, ku thotë se Noteri në kuptim të nenit 46 vërteton dokumentin kopje nga origjinali, gjë që e vërteton se nuk është marrëveshja e noterizuar për projektin, por është vetëm vërtetim nënshkrimi i kopjes së marrëveshjes. Lidhur me këtë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se nuk e përmbush plotësisht kriterin e kërkuar të AK-së i cili është kërkuar në FDT dhe njoftimin për kontratë. Pra, AK ka shkelur nenin 59 të LPP-se, konkretisht paragrafi 4 i këtij neni që thotë:

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Ashtu siç pretendon OE ankues se OE i rekomanduar nuk e ka marrëveshjen e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, pos që e ka noterizimin e bërë nga pronari për LOT 2 – Bujar Shabani. Pra, duke u bazuar në kërkesën e AK-së dhe dëshmitë që OE i rekomanduar i ka futur në dosje, nuk e plotëson kriterin e kërkuar OE i rekomanduar. AK duhet të këtë parasysh nenin 7 të LPP-së (mos-diskriminimi) e OE-ve dhe respektimin e kriterëve të kërkuara sipas nenit 59 të LPP-se, duke mos anashkaluar nenin 1 të LPP-së, nenin 6, nenin 61 dhe 72 të LPP-së. Pra, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Pra, ky pretendim është shqyrtuar me herët dhe sipas pikës 2.16 të nenit 105 të LPP-se, është çështje e gjykuar "Res Judicata".

Përgjigje në pretendimin e dyte ankimor, Lidhur me pretendimin e dyte ankimor për pajisjet mjetet e punës:

Ndërsa sa i përket OE të shpallur fitues ju sqarojmë se ky OE është i papërgjegjshëm pasi që nuk i ka plotësuar kriteret e FDT përkatësisht ANEKSI nr 7 Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshem.

Përkatësisht pika nr 6 ku kërkohej Rul me kapacitet mbi 10 ton dhe ku në këtë pikë parashihet Rul për ngjeshje Toke 2 cope.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dy cilindër me shenime HAMM HD 75K, HAMM HD +90VV, këta dy cilindër nuk janë adekuat sipas kërkesës së AK-së pasi që që të dy këta cilindër janë për ngjeshje të asfaltit dhe nuk mund të përdoren për ngjeshje të dheut gurit apo Zhavorit dhe kërkesa e AK-së ka qenë për cilindër për ngjeshje Toke pasi që Cilindrat për ngjeshjen e Asfaltit janë kërkuar në pikën 10 të aneksit nr 7 të FDT-s.

Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT; Dëshmia 4. Lista e pajisjeve të nënshkruar dhe e vulosur, duke plotësuar listën në Aneksin 7, të dosjes së tenderit. Mjetet dhe pajisjet duhet të dëshmohen me njërin nga dokumentet me librezën e regjistrimit, faturë, librezë, DUD doganor apo marrëveshjen mbi qiranë e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët.

pas aneksit 7 te DT-se lista e pajisjeve ka qene;

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar minimum(cope)
1	Bager minimum 65 ton	1
2	Bullduzher për rrafshimin e terreni minimu 8 ton	1
3	Eskavator me kapacitet minimum 24 ton	2
4	Eskavator me kapacitet minimum 16 ton	1
5	Eskavator me kapacitet minimum 7 ton	2
6	Rul me kapacitet mbi 10 tonë	2
7	Cilinder vibruet 12-16t	2
8	Grejder rrafshues min. 12 ton	2
9	Finisheri për shtrirjen e asfaltit	1
10	Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur)	2
11	Kamion kiper me kapacitet minimum 10m ³	6

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, për pajisjen siç pretendon OE ankues, AK këto pajisje mund ti verifikoj ne terren me komision sipas kriterëve që i ka kërkuar AK dhe kjo mund te qartësohet dhe vërtetohet lehte, pasi që kriteri i kërkuar Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT; Dëshmia 4. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur , duke plotësuar listën në Aneksin 7, të dosjes së tenderit. Mjetet dhe pajisjet duhet të dëshmohen me njërin nga dokumentet me librezën e regjistrimit, faturë, librezë, DUD doganor apo marrëveshjen mbi qiranë e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët.

-Pasi që ka qene kërkesë e AK për pajisjet, atëherë bazuar ne listën e prezantuar te pajisjeve AK për çdo paqartësi mund ti verifikoj dhe sqaroj sipas nenit 72 te LPP-se. pra, është përgjegjësi e AK-se është për verifikim te pajisjeve siç i ka kërkuar ne FDT dhe njoftim për kontrate. Pretendimi ankimor pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që te ankesa nr.170/21 te aprovohet e bazuara, kurse ankesa 172/21 te aprovohet e pjeserishme dhe lënda te kthehet ne rivlerësim dhe gjate rivlerësimit, AK ti respektoj vendimin e OSHP-se 872-879/20 kriteret e vet-përcaktuara si ne FDT dhe NJK, sipas nenit 59 te LPP-së dhe te respektoj nenin 61 dhe 72 te LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 10.03.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 12.03.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar, Ne përgjigje te ekspertizës së ekspertit Tuaj dhe pas analizës që I është bërë Raportit të Eksperti Shqyrtues lidhur me lenden : “Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatra sipas lot1 dhe lot 2” me Numri i prokurimit: VU644-20-4423-5-1-1, dhe me Nr. Te brendshëm Vu644-20-050-5-1-1, njoftojmë OSHP-n se ne si A.K. nuk pajtohemi me te gjeturat dhe Mendimin e ekspertit Shqyrtues te paraqitura ne Raport. Si A.K mbetemi në tersi pranë vlerësimit tone dhe se ndajmë mendimin se vlerësimi ynë ka qen i drejt dhe i bazuar në dispozitat përkatës ligjore te LPP-së. Ne do te mbesim ne pritje deri ne Vendimin e drejt përfundimtar qe do ta merre OSHP dhe do ta zbatojmë ne tersi si te tillë, po ashtu kërkojmë qe brenda mundësive ky aktivitet te trajtohet me urgjenca për shkak te rëndësisë qe ka për qytetaret e Komunës tone. Me respekt,

Operatori Ekonomik: “Rahovica Commerce”SH.P.K.-Ferizaj, me datë: 12.03.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.03.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet ankimore te OE “Rahovica Commerce”SH.P.K.-Ferizaj,

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues se AK ka kërkuar nga OSHP te na fut ne listën e zezë. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se për këtë pretendim OSHP ka lëshuar një vendim nr.872-879/20 për vërtetësinë e fakteve. AK ka pranuar një vendim e mbi te cilin vendim te OSHP-se nr.872-879/20 është vërtetuar ne Vendimin 872-879/20, ku inxhinieri Gazmend Himaj është i punësuar, ka kontrate, ka diplome, ka te paguara kontributet si punëtor, ka sjellë diplomën e vërtetuar. AK duhet te zbatoj vendimin e OSHP-se 872-879/20 dhe themi se ky pretendim është i bazuar dhe AK duhet te zbatoj vendimin e OSHP-se

për rastin në fjale. Ky pretendim ankimor pasi është shqyrtuar ne vendimin 872-879/20, mund te trajtohet sipas pikës 2.16 te nenit 105 te LPP-se, dhe mund te quhet Res Judikata (çështje e gjykuar).

Lidhur me pretendimin ankimor se AK ka shkelur nenin 1, nenin 6 te LPP-se. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, sqaron se lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK duhet te respektoj nenin 1 dhe 6 te LPP-se, qëllimi i Ligjit është shfrytëzimi sa me ekonomik i buxhetit dhe AK ti kërkoj sqarime shtese ne fazën e rivlerësimit qe ne rast se arrihet kriteri i kërkuar nga OE ankues AK te shpërblen me kontrate OE ankues, ne rast se nuk arrihet kriteri i kërkuar AK te vazhdoj me OE tjerë. Pra qëllimi i LPP-se konkretisht nenit 59.2, nenit 72 te LPP-së dhe nenit 39.8 te RRUOPP-së është ti kërkojen sqarime shtese. Pra, AK duke u bazuar ne nenin 1 dhe 6 te LPP-së qe interesi i AK është te kursej buxhetin, AK duhet te ketë parasysh këto gjera dhe ka qene dashtë te kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së, lidhur me listën e projekteve, konkretisht referencat. Duke marr parasysh kursimin e buxhetit sipas nenit 1 dhe 6 te LPP-se AK për çdo paqartësi mund te kërkoj sqarime sipas nenit 72 te LPP-së.

OE ankues pasi qe i plotëson kriteret sipas vendimit 872-879/20, OE ankues është me i lire për LOT 1 – 4,993.93 euro, kurse ne LOT 2 – 35,157.98 euro. Pra, Dallimi ne mes te OE ankues dhe OE se rekomanduar është 40,151.91 €, qe nënkupton se OE ankues është me i lire se OE i rekomanduar.

Pra, AK duhet te ketë parasysh kursimin e buxhetit sipas nenit 1 dhe 6 te LPP-së dhe AK duhet te zbatoj vendimin e OSHP-se nr.872-879/20. Pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues se AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve) .paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues , sqaron se lidhur me pretendimin ankimor, AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se, dhe 72 te LPP-së sepse duke mos e respektuar vendimin e OSHP-se 872-879, AK bën shkeljen e nenit 59 te LPP-se, andaj AK duhet te ketë parasysh vendimin e OSHP-se 872-879/20 dhe te zbatoj kriteret e kërkuara sipas LPP-se, po ashtu edhe neni 72 i LPP-se shkelet nga AK sepse sipas vendimit te OSHP-se 872-879/20 AK duhet te kërkoj sqarime nga OE për referencat, por AK një gjë te tille nuk e ka bere. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues se AK ka bere shkeljen e nenit 61 te LPP-se, sipas pretendimit te OE ankues ne disa pozicione te paramases se OE-se se rekomanduar. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues, sqaron se AK lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se OE i rekomanduar ka çmime jo-normalisht te ulëta sipas pozicioneve siç pretendon OE ankues. Poz.3,4,5,8,10,12,13,17,19 dhe 20. Si me larte. Pra, OE ankues ka te bashkangjitur ofertën për:

1. Zhavorr
2. Gypa te plastikes

3. Armature

4. Beton

OE ankues ka bashkangjitur disa oferta ne ankesën e tij për:

1.Gyp i bri njëzuar Fi 315 mm – 6.85 €/m²; 6.50 €/m² ;

2.Beton C 25/30 – 42 €/m³; 39.00 €/m³

3.Kapak kompozit – sipas DUD-it Goganor – 61.93 €

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar ka çmime jo-normalisht te ulëta ne pozicionet e lartpërmendura, paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se ne lenden a ankesës se OE ankues Rahovica ka te bashkangjitura disa oferta për artikujt e përmendura dhe sipas këtyre ofertave rezulton se OE i rekomanduar ka çmime te ulëta për pozicionet ne fjale dhe AK sipas nenit 61 te LPP-se, te kërkoj sqarime për pozicionet ne fjale, andaj përgjegjësi e AK-se është te veproj konform nenit 61 te LPP-se. Paragrafi 2 i nenit 61 te LPP-së thotë (citim): Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalishtulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me: 1.ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; 2.çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; 3.çfarë do kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, 4.ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose 5.origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara. Pretendimi i ankimor i OE ankues ne këtë pike është pjesërisht i bazuar, sepse AK ka qene dashtë ti kërkoj sqarime shtese OE ankues për çmime jo normalisht te ulëta.

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se AK ka bere shkeljen e nenit 108/A te LPP-se, dhe shkelja e nenit 7 te LPP-se, nenin 59 te LPP-se. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se AK-Komuna Vushtrri nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues, është shkelje e nenit 108/A te LPP-së, shkelja e nenit 7 të LPP-së dhe nenit 59 te LPP-së, sepse OE ankues pretendon se AK nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-se nr.872-879/20 për inxhinierin në fjale, pasi qe lidhur me këtë pike e sqaron qarte vendimi i OSHP-se 872-879/20 dhe për te cilin pretendim për inxhinierin ne fjale është shqyrtuar ne vendimin e mëparshëm dhe AK ne fazën e rivlerësimit ka qene dashtë ta respekton vendimin ne fjale. Pra, Kjo mund te quhet çështje e gjykuar “Res Judicata”, sipas pikës 2.16 te nenit 105 te LPP-se.

Paneli shqyrtues ne vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet ankimore te N.P.SH“Bageri”-Ferizaj.

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka licencën nga KPMM, lidhur me marrëveshjen e noterizuar për furnizim me beton. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron, se OE i rekomanduar ka një marrëveshje ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit dhe këtë e sqaron qarte vendimi 872-879/20 qe thotë:

Dëshmia 6. Duhet të dëshmohet kopja e Licencës leje për aktivitete te veçanta , valide dhe e vlefshme e lëshuar nga Agjencia për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licenca e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar nuk e ka te noterizuar marrëveshjen për Furnizim me zhavorr ne emër te qiramarrësit dhe qiradhënësit, kurse OE i rekomanduar nuk e plotëson këtë kriter. Pra, nuk është marrëveshja e noterizuar sipas kërkesës së AK-së, por ka vetëm vërtetim nënshkrimi i dt.11.03.2020, ku thotë se Noteri në kuptim të nenit 46 vërteton dokumentin kopje nga origjinali, gjë që e vërteton se nuk është marrëveshja e noterizuar për projektin, por është vetëm vërtetim nënshkrimi i kopjes së marrëveshjes. Lidhur me këtë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se nuk e përmbush plotësisht kriterin e kërkuar të AK-së i cili është kërkuar në FDT dhe njoftimin për kontratë. Pra, AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se, konkretisht paragrafi 4 i këtij neni qe thotë:

“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në ljalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Ashtu siç pretendon OE ankues se OE i rekomanduar nuk e ka marrëveshjen e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, pos që e ka noterizimin e bërë nga pronari për LOT 2 – Bujar Shabani, Pra, duke u bazuar në kërkesën e AK-së dhe dëshmitë që OE i rekomanduar i ka futur në dosje, nuk e plotëson kriterin e kërkuar OE i rekomanduar. AK duhet te këtë parasysh nenin 7 të LPP-së (mos-diskriminimin) e OE-ve dhe respektimin e kriteve te kërkuara sipas nenit 59 të LPP-se, duke mos anashkaluar nenin 1 të LPP-së, nenin 6, nenin 61 dhe 72 të LPP-së. Pra, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Pra, ky pretendim është shqyrtuar me herët dhe sipas pikës 2.16 te nenit 105 te LPP-se, është çështje e gjykuar “Res Judicata”.

Lidhur me pretendimin e dyte ankimor për pajisjet mjetet e punës:

Ndersa sa i perket OE te shpallur fitues ju sqarojme se ky OE eshte i papergjegjshum pasi qe nuk i ka plotesuar kriteret e FDT perkatesishte ANEKSI nr 7 Paisjet dhe mekanizimi i obligueshem.

Perkatesishte pika nr 6 ku kerkohet Rul me kapacitet mbi 10 ton dhe ku ne kete pike parashihet Rul per ngjeshje Toke 2 cope.

OE i rekomanduar per kontrate ka ofruar dy cilinder me shenime HAMM HD 75K , HAMM HD +90VV , keta dy cilindra nuk jane adekuat sipas kerkese se AK-s pasi qe te dy keta cilindra jane per ngjeshje te asfaltit dhe nuk mund te perdoren per ngjeshje te dheut gurit apo Zhavorit dhe kerkesa e AK-s ka qene per cilinder per ngjeshje Toke pasi qe Cilindrat per ngjeshjen e Asfaltit jane kerkuar ne piken 10 te aneksit nr 7 te FDT-s.

Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT; Dëshmia 4. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur , duke plotësuar listën në Aneksin 7, të dosjes së tenderit. Mjetet dhe pajisjet duhet të dëshmohen me njëërën nga dokumentet me librezën e regjistrimit, faturë, librezë, DUD doganor apo marrëveshjen mbi qiranë e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët.

pas aneksit 7 te DT-se lista e pajisjeve ka qene;

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar minimum(cope)
1	Bager minimum 65 ton	1
2	Bullduzher për rrafshimin e terreni minimu 8 ton	1
3	Eskavator me kapacitet minimum 24 ton	2
4	Eskavator me kapacitet minimum 16 ton	1
5	Eskavator me kapacitet minimum 7 ton	2
6	Rul me kapacitet mbi 10 tonë	2
7	Cilinder vibrues 12-16t	2
8	Grejder rrafshues min. 12 ton	2
9	Finisheri për shtrirjen e asfaltit	1
10	Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur)	2
11	Kamion kiper me kapacitet minimum 10m ³	6

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, për pajisjen siç pretendon OE ankues, AK këto pajisje mund ti verifikoj ne terren me komision sipas kriterave qe i ka kërkuar AK dhe kjo mund te qartësohet dhe vërtetohet lehte, pasi qe kriteri i kërkuar Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT; Dëshmia 4. Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur , duke plotësuar listën në Aneksin 7, të dosjes së tenderit. Mjetet dhe pajisjet duhet të dëshmohen me njëërën nga dokumentet

me librezën e regjistrimit, faturë, librezë, DUD doganor apo marrëveshjen mbi qiranë e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët.

-Pasi që ka qenë kërkesë e AK për pajisjet, atëherë bazuar në listën e prezantuar të pajisjeve AK për çdo paqartësi mund të verifikoj dhe sqaroj sipas nenit 72 të LPP-së. Pra, është përgjegjësi e AK-se është për verifikim të pajisjeve siç i ka kërkuar në FDT dhe njoftim për kontratë. Paneli shqyrtues vjen në përfundim se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 61, 72 dhe neni 60 i LPP-së - kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, si dhe vendimi OSHP-së PSH nr. 872-879/20.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dhe të respektoj vendimin e OSHP-së PSH nr. 872-879/20, nenit 59 nenin 61 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 /AK "KK-Vushtri",
- 1x1 / OE "Rahovica Commerce"SH.P.K.-Ferizaj,
- 1x1 OE: N.P.SH"Bageri"-Ferizaj,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.